



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezuar Received / Delivered	12.07.2023	3	viti year
Organ / Rrethi Org / Unit	No Prot Prot No	Shtypje / Appendix	Sasia Quantity
SKRIBSHUK	5176/2023		117



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.732/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.732/2022 të datës 15.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ nga Prishtina, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 12.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.732/2023 e datës 15.05.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 15.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.732/2023, kundër njoftimit të datës 27.04.2023 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me pamundësinë e vazhimit në procedurën e rekrutimit për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, me pretendimet së Komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar drejt aplikacionin e ankuesit pasi që i njëjti plotëson të gjitha kriteret për pozitën e shpallur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

22.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, ndërsa ky i fundit me data 26.05.2023 ka përcjell shkresat referuar kësaj çështje në shqyrtim dhe vendosje.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokoll 4742/2023 të datës 14.06.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4231/2023 të datës 15.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 12.05.2023 nga ankuesi për Këshillin; E-maili i datës 05.05.2023-lidhur me shqyrtimin e ankesës së ankuesit nga Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP; E-maili i datës 29.04.2023 nga ankuesi për parashtrimin e ankesës në DMZP; Dëshmi e datës 28.04.2023 e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes; Vërtetim i datës 28.04.2023 i lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes; Dekret me NR:DFSK-002-2012 i datës 16.02.2012 i nënshkruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 22.05.2023 për organin e punësimit nga Këshilli; Përgjigje në ankesë e datës 26.05.2023 nga Arkiva e MPB-së për Këshillin; Ofrimi i dëshmimeve me nr.862 të datës 26.05.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme; E-maili i datës 04.05.2023 nga Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP; E-maili zyrtar i datës 02.05.2023 i lëshuar nga Zyrtari për Zhvillimin e konkurrimit në DMZP; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve të aprovuar; Lista e kandidatëve të refuzuar; Njoftimi i datës 27.04.2023 për kandidatët që vazhdojnë procedurën e mëtejme të rekrutimit për pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/DMZP; Kopja e konkursit i datës 14.03.2023 (data e njoftimit), afati për aplikim prej datës 13.04.2023 deri më datën 20.04.2023 i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme; Aplikacioni i datës 19.04.2023 me nr.reference të shpalljes RN00011216; Vendim i datës 15.05.2019 me ref. Nr.6-2051 për njohjen e diplomës Master i Studimeve Strategjike të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Diplomë e datës 12.11.2018 me nr.2740 të lëshuar nga Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë për programim e datës 04.11.2011 e lëshuar nga Drejtori i shkollës posdiplomike në Kaliforni; Çertifikatë e datës 21.10.2011 për trajnime e lëshuar nga Instituti për Menaxhimin e Asistencës së Sigurisë ; Çertifikatë e datës 15.09.2011 e lëshuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Çertifikatë e datës 18.03.2011 e lëshuar nga Qendra Europiane për studimet e sigurisë; Çertifikatë e datës 07-08.10.2014; Çertifikatë e datës 29.11.2007 e lëshuar nga KFOR-i; Çertifikatë e datës 03.03.2007; Çertifikatë e datës 25.08.2006; Çertifikatë e datës 04.11.2005; Çertifikatë e datës 04.12.2009; Medale e datës 17.08.2016; Çertifikatë e datës 16.05.2017; Letër motivuese nga ankuesi; Çertifikatë për njohje e muajit gusht 2021; Çertifikatë e datës 07.08.2014; Letër rekomandimi e datës 22.11.2021 e lëshuar nga këshilltarët e NATO-së; Letër rekomandimi i datës 15.03.2019; Letër rekomandim; Vërtetim i datës 23.11.2021 e lëshuar nga kolegji cactus; Letër motivimi i datës 19.04.2023; Përmbledhje e jetëshkrimit; Shkresë e datës 19.04.2023 e lëshuar nga AUK; Pasqyra e llogarisë së trustit prej datës 12.03.2008 deri më datën 14.04.2023; Çertifikatë mbi dënimet penale me nr.serik BIF000A6600F0495e datës 03.04.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ; E-maili i datës 26.06.2023 i lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit dhe e-maili i datës 27.04.2023 i lëshuar nga Zyrtari për Zhvillimin e Konkurrimit në DMZP.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat e marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 14.03.2023 ka shpallur në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) Konkursin për pranimit të hapur, me numër reference RN00011216 për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, klasa Drejtues i Lartë 1, me mandat katër (4) vjeçar.

Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 13 prill deri me 20 prill 2023 e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi, mirëpo DMZP-ja në fazën e shqyrtimit paraprak përmes njoftimit të datës 27 prill 2023 ka njoftuar ankuesin se i njëjti nuk mund të vazhdoj me tej në këtë procedurë të pranimit, për shkak se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës pasi që nuk posedon pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe deklaratën më shkrim për të dëshmuar së ndaj tyre nuk ka pasur masë disiplinore të largimit nga pozita e zyrtarit publik në punë në pesë vitet e fundit.

Kundër njoftimit të datës 27 prill 2023 datës 20.09.2022 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimi Civil të Kosovës, me pretendimin së Njësia përgjegjëse në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka bërë vlerësim jo të drejtë pasi që sipas ankuesit i njëjti ka plotësuar kriteret për pozitën e punë ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Në kuptim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, lidhur me emërimin e pozitave të larta drejtuese, përkatësisht nenit 40 më të cilin është përcaktuar se: *1. Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil. 2. Konkurrimi organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për çdo institucioni tjetër shtetëror (në vijim Njësia e Pranimit). 3. Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 30 ditë, përpara datës të caktuar për paraqitjen e aplikimit, nga Njësia e Pranimit, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. 4. Shpallja e konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, përfshin pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, përshkrimi i punës, kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, që duhet t'i plotësojnë kandidatët, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e konkurrimit, dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim dhe afatin për paraqitjen e aplikimit... 9. Në rast se procedura e konkurrimit përfundon pa të paktën dy kandidatë fitues të vlerësuar me më shumë se 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet një procedurë e dytë konkurrimi. Procedura e dytë e konkurrimit është e hapur dhe në të mund të marrë pjesë çdo kandidat, që i plotëson kërkesat e përgjithshme për pranimin në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme për pozitën përkatëse nga brenda apo jashtë Shërbimit Civil..."*

Po ashtu Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe Rregulloren(QRK) Nr.1/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues gjegjësisht nenin 6 me dispozita e të cili parashihet se: *"1. Procedura e konkurrimit për pozitë e kategorisë së lartë drejtuese organizohet nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për institucionet e administratës shtetërore dhe nga njësia*

e burimeve njerëzore e institucionit, për institucionin tjetër shtetëror (në tekstin në vijim për të dy njësitë - Njësia përgjegjëse).... 4.Njësia e pranimit, bën njoftimin për hapjen e procedurës së konkurrimit për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në afat jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë kalendarike para datës të caktuar për pranimin e aplikacioneve. 5. Afati për pranimin e aplikacioneve është tetë (8) ditë kalendarike. 6. Njoftimi për shpalljen e konkursit për herë të parë është për nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil dhe bëhet në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit për nëpunësit civilë (SIMBNJ) dhe në ueb faqen e dhënat si në vijim: 6.1. titullin e pozitës për të cilën zhvillohet konkurrimi; 6.2. përshkrimin e përgjithshëm të punës për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi; 6.3. kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të Ligjit për Zyrtarët Publikë; 6.4. kërkesat e përgjithshme formale; 6.5. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 6.6. kërkesat specifike që duhet t'i plotësojnë kandidatët sipas paragrafit 2 të nenit 5 të kësaj rregullore; 6.7. dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim, mënyrën, procedurën dhe afatin për paraqitjen e aplikimit. 6.8. datën e fillimit të zhvillimit të procedurës së konkurrimit; 6.9. datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; 6.10. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve; 6.11. datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar; 6.12. mënyrën e njoftimit/komunikimit me kandidatët, përmes postës elektronike; 6.13. mënyrën e aplikimit (përmes ueb aplikacionit - online); 6.14. informatën se për herën e parë kanë të drejtë të konkurojnë vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil; dhe 6.15. kërkesën për letër motivimin..." Nenin 7 i cili ka përcaktuar se: ...3.Së bashku me aplikacionin për konkurrim, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues në vijim: 3.1. kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi; 3.2. kopjet e dëshmisë së punësimit që përfshin pozitën dhe datat e mbajtjes së pozitës; 3.3. kopjet e dokumenteve që dëshmojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion...9.Shpallja e hapur e konkurimit dhe pranimit i aplikacioneve bëhet në pajtim me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 6 të kësaj Rregullore... Nenin 8 ku përcaktohe se: Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional.... 5. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Njoftimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e papërmbyshura dhe u dërgohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve. 6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin - kërkesë me shkrim për sqarime shtesë ose të paraqiten tek Njësia Përgjegjëse për t'u njohur me arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm. 7. Njësia Përgjegjëse, brenda afatit prej pesë (5) ditëve kalendarike duhet të përgjigjet me shkrim në kërkesën e kandidatit si në paragrafin 6 të këtij neni, duke dhënë arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm. 8. Kandidati i pa kënaqur me përgjigjen me shkrim si në paragrafin 7 të këtij neni, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej tetë (8) dite kalendarike pas pranimit të përgjigjes.

Sipas Konkursit me numër referencë RN00011216 për pozitën e punës "Sekretar i Përgjithshëm" në Ministrinë e Mbrojtjes si kërkesat të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve. E preferuar në fushat që ndërlidhen me fushëveprimin e institucionit ku rekrutohet. **Përvoja e punës e kërkuar:** së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë së paku pesë(5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.

Ndërsa si dëshmi janë kërkuar: *Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit; Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë. Përvoja e deklaruar e punës, sipas kushteve të konkursit, në Organizatat Jo Qeveritare, dëshmohet, përkatësisht merret parasysh, nëse kumulativisht përmbushen kushtet si në vijim. "Është përgjegjësi e kandidatit që të sigurojë prova specifike që tregojnë se secili prej këtyre kritereve është përmbushur. Kandidatët gjithashtu duhet të bëjnë të qartë në aplikimin e tyre çdo përvojë pune që është fituar në një OJQ.-Dëshmohet me statutin apo aktin tjetër të organizatës se pozita në të cilën është deklaruar përvoja e punës, ekziston në kuadër të organizimit dhe funksionimit të OJQ -së; -Aktin e emërimit apo caktimit me votim të organeve që sipas statutit të OJQ -së, kanë kompetencën për të emëruar/caktuar personat në pozitën e caktuar në OJQ; -Së paku njërën nga dëshmitë: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale ose të ardhurave tjera të tatueshme; Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet nëse referencat e përvojës, mbështeten me aktet përkatëse noteriale; Letër motivimi;Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës; Dëshmi që nuk ka një masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit (për kandidatët që janë zyrtare publik dëshmia lëshohet nga institucioni/et përkatës në të cilën ka punuar zyrtari në pesë vitet e fundit). Kandidatët e jashtëm paraqesin deklaratën me shkrim të vetë-nënshkruar, për të dëshmuar se ndaj tyre nuk ka pasur masë disiplinore të largimit nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit". Certifikate nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;si dhe çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Andaj, bazuar në kuadrin ligjor si me sipër si dhe duke u bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit vlerëson së Njësia Përgjegjëse përkatësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, sepse sipas dokumentacionit të përcjell nga ankuesi në procedurën e aplikimit rrjedhe së ankuesi përkitazi me kriteret e përgjithshme formale posedon Diplomën Nr.2740 të datës 11 nëntor 2014, të lëshuar nga Fakulteti Filologjik i Universitetit "Hasan Prishtina" për përfundimin e studimeve Dega Gjuhë dhe Letërsi Anglezë, duke marre titullin Profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze; Diplomën e lëshuar nga Kolegji "US Army War College" për Master të Studimeve Strategjike, e njohur me Vendimin Nr.ref.6-2051 të datës 15.05.2019 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa, lidhur me përvojën e punës ankuesi në formularin e aplikimit ka deklaruar se nga data 20.09.1999 deri me 01.07.2003 ka punuar në TMK në pozitën e punës Oficer Personeli, nga data 01.06.2002 deri 31.08.2023 ka punuar në TMK si Shef i degës së gjuhëve të huaj, nga datat 01.09.203 deri 11.03.2006 ka punuar asistent ushtarak i Komandantit të TMK-së, nga data 10.03.2006 deri 10.11.2009 ka ushtruar pozitën e Shefit të Kabinetit të Komandantit të TMK-së, mirëpo ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi / vërtetim të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë, si dhe pasqyrën e pagesave në Fondin e kursimeve pensionale apo nga ATK-ja ashtu siç është përcaktuar në pikën 7 të Konkursit me numër reference RNO000011216.

Me tej ankuesi ka deklaruar së nga data 10.01.2009 deri me datë 28.03.2012 ka punuar në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës në pozitën Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, ndërsa nga data 03.04.2012 deri 15.04.2019 ka punuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme si Atashe i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ambasadën në Republikën së Kosovës në Uashington DC dhe

Konsull i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës në LOWA. Po ashtu, përkitazi me këtë përvojë punë ankuesi përveç letër rekomandimeve mirëpo ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi /vërtetim të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë, si dhe pasqyrën e pagesave në Fondin e kursimeve pensionale apo nga ATK-ja ashtu siç është përcaktuar në pikën 7 të Konkursit me numër reference RNO000011216. Në mungesë të këtyre dokumenteve Këshilli bazuar në provat shtesa të kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes rrjedhimisht sipas emailit të datës 26.06.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Mbrojtjes ka gjetur se ankuesi nga data 21.01.2009 deri me date 13.12.2011 ka qenë Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa nga data 14.12.2011 deri me datë 01.08.2016 ka qenë Atashe në SHBA, ku më përfundimin e këtij posti i njëjti nga data 09.08.2016 me kërkesë për demobilizim vullnetar është liruar nga shërbimi në Ministrinë e Mbrojtjes, uke shkuar në pushim të parakohshëm.

Ankuesi në dokumentacionin e aplikimit ka bashkangjitur edhe vërtetimin e datës 23 nëntor 2023 të lëshuar nga Biznesi "Cactus" me cilin vërtetohet se nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, dhe vërtetimin e datës 19 prill 2023 të Drejtorit të AUK-ut është i punësuar si asistent fakulteti nga janari 2020 e tutje, mirëpo ankuesi nuk ka ofruar dëshmi/vërtetim se në çfarë pozite është i punësuar në kompaninë Cacctus, përjashtimisht, sipas Pasqyrës se Trustit konstatohet se ankuesi është i deklaruar si punëtor në këtë kompani nga qershori 2020 e tutje.

Po ashtu Kolegji nga provat materiale të lëndës, ka gjetur se ankuesi me rastin e aplikimit përkundër fakti që i njëjti ka prezantuar dëshmi nga kompanitë private si Cacctus dhe AUK së ndaj tij nuk është zbatuar ndonjë masë disiplinore, i njëjti nuk ka ofruar deklaratë me shkrim për të dëshmuar së ndaj tyre nuk ka pasur masë disiplinore të largimit nga pozita e zyrtarit publik në punë në pesë vitet e fundit.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe faktet e me sipërme, Kolegji vlerëson se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të nevojshëm që provojnë përvojën pesë vjeçare të ankuesit në pozita drejtuese, kështu që mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Njësia Përgjegjëse ka vepruar në pajtim me nenin 8 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku është përcaktuar se: *Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Njoftimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e papërmblura dhe u dërgohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.."*

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij nendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.732/2023

Sabile AVDYLI
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI
Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Sekretarisë për Emërime të Larta në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Arkivit të KPMSHCK-së.